

## “KARTA GOL”

### 1. Fushata

Fushata promociionale “Karta Gol” (në vijim “Fushata”) organizohet nga Banka Credins sh.a., në kuadër të lancimit të kartës Mastercard Prepaid General Purpose me identitetin vizual të Kombëtares Shqiptare të Futbollit.

Fushata zhvillohet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore.

### 2. Përkufizimet

“Llogaria” do të thotë llogaria e lidhur me Kartën e parapaguar, e hapur në Bankën Credins në emër të një individi mbi moshën 18 vjeç.

“Kartë” do të thotë kartë e vlefshme e parapaguar Mastercard e lëshuar nga Banka Credins

“Karta Gol” karta Mastercard Prepaid General e lëshuar gjatë/pas datës 04 Qershor 2026

“Mbajtës i kartës” do të thotë një person që është përdorues i një Karte

“Transaksion blerjeje me kartë” blerje në Pos fizik apo virtual, brenda ose jashtë Shqipërisë

“Cashback” shuma e kredituar nga Banka Credins në llogarinë e kartës

### 3. Kohëzgjatja e Fushatës

Fushata do të jetë e vlefshme nga data 04 Qershor 2026 deri më 25 Korrik 2026.

Banka Credins rezervon të drejtën të mbyllë, ndryshojë ose ndërpresë Fushatën edhe përpara këtij afati, për arsye operationale, tregtare ose në rast të ezaurimit të fondit promociional, pa qenë e detyruar të japë kompensime shtesë ndaj pjesëmarrësve.

Çdo ndryshim lidhur me Fushatën do të publikohet në kanalet zyrtare të komunikimit të Bankës Credins.

### 4. Kartat pjesëmarrëse në Fushatë

Pjesë e Fushatës janë vetëm kartat:

- ✓ Mastercard Prepaid General Purpose;
- ✓ të lëshuara nga Banka Credins;
- ✓ të emetuara gjatë periudhës: 04 Qershor 2026 deri në përfundimin e Fushatës.

Kartat e lëshuara përpara datës 04 Qershor 2026 nuk përfshihen në këtë Fushatë.

### 5. Përfituesit e Fushatës

Në fushatë përfshihen klientët individë të Bankës Credins të cilët:

- ✓ pajisen me kartën pjesëmarrëse gjatë periudhës promociionale;
- ✓ kryejnë të paktën një (1) transaksion blerjeje me kartë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të kartës.

### 6. Përfitimet e Fushatës

Klientët që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore do të përfitojnë:

- ✓ pajisje me kartën “Karta Gol” pa komision lëshimi;
- ✓ cashback në vlerën 10 (dhjetë) Euro.

Cashback do të akordohet vetëm një herë për çdo klient/kartë gjatë gjithë periudhës së Fushatës.

## 7. Kushtet e Përfitimit të Cashback

Përfitimi i cashback realizohet vetëm në rast se:

- ✓ karta është aktive dhe në status normal përdorimi;
- ✓ klienti ka kryer të paktën një transaksion blerjeje të suksesshëm me kartë brenda 30 ditëve nga data e lëshimit;
- ✓ transaksioni është kontabilizuar dhe regjistruar me sukses në sistemet e Bankës.

Për efekt të kësaj Fushate, konsiderohen të vlefshme vetëm transaksionet e blerjes me kartë (POS ose online/e-commerce).

Nuk konsiderohen transaksione të vlefshme:

- ✓ tërheqjet cash në ATM ose POS;
- ✓ transfertat ndërmjet llogarive;
- ✓ transaksionet refund/rimbursim;
- ✓ transaksionet e anuluar ose të refuzuara;
- ✓ transaksionet që Banka i konsideron me natyrë abuzive, fiktive ose në kundërshtim me qëllimin e Fushatës.

## 8. Kreditimi i Cashback

Cashback do të kreditohet në kartën ose llogarinë përkatëse të klientit brenda muajit pasardhës nga data e kryerjes së transaksionit që plotëson kushtet e kësaj Fushate.

Kreditimi i cashback do të realizohet vetëm pasi transaksioni të jetë përpunuar dhe kontabilizuar me sukses në sistemet e Bankës. Për kreditimin e cashback do të aplikohet Tatimi sipas legjislacionit në fuqi.

## 9. Të Drejtat e Bankës

Banka Credins rezervon të drejtën:

- ✓ të verifikojë vlefshmërinë e transaksioneve dhe përmbushjen e kushteve të Fushatës;
- ✓ të përjashtojë nga përfitimi klientët në rast evidentimi të elementëve të mashtrimit, abuzimit ose përdorimit jo të rregullt të kartës;
- ✓ të refuzojë përfitimin e cashback në rast të mosplotësimit të kushteve të kësaj Rregulloreje;
- ✓ të ndryshojë termat dhe kushtet e kësaj Rregulloreje, duke publikuar versionin e përditësuar në faqen zyrtare të bankës.

## 10. Publikimi i Rregullores

Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare të [Bankës Credins](#) dhe hyn në fuqi nga data 04 Qershor 2026.